



Npi – 01/148 datë: 03.06.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Në bazë të neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe në bazë të Kërkesës të Ministrisë të Pushtetit Lokal Nr.43-83/9 të datës 30.04.2021 për Rishqyrtimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, Npi – 01/17 datë: 28.01.2021. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më datën: 03.06.2021 aprovoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2021, Npi – 01/17 të datës: 28.01.2021

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 03.06.2021, unanimitisht aprovoi, ndryshimet në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, Npi – 01/17 datë: 28.01.2021, si vijon:

1. Në Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2021, Npi – 01/17, Neni 6 deri te neni 6.15 komplet hiqet (fshihet) nga Rregullorja.
(A r s y e t i m: Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, tarifat për shërbimet kadastrale do ti zbatojë drejtëpërdrejtë nga MEA-AKK-Prishtinë, pa qenë e obliguar që të njejtat të përfshihen në Rregulloren Komunale).
2. Propozim i ri: Te neni 4.7 shtohen edhe fjalët, “Lirohen edhe të gjitha subjektet afariste që kanë në shfrytëzim pronat e pa luajtshme komunale në bazë të vendimeve për dhënie në shfrytëzim pronën e pa luajtshme komunale” sipas neneve 4.2 dhe 4.3.
3. Përmirësohet baza ligjore e Rregullores për ndryshimin e Rregullores për taksë, tarifa dhe gjoha për vitin 2021, Npi-01/17 date 28.01.2021, si vijon: “Bazuar në nenin 12.2. pika (c) dhe nenin 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenet 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Neni 15.1.8 neni 23 dhe 34 të Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060; Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës”.

II

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Rregullorja u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj